



Praktika e GJEDNJ-së, obligim në letër

(Analizë e zbatimit të KEDNJ-së dhe praktikës
së GJEDNJ-së nga gjykatat në Kosovë)



Autor: Gzim Shala

Me kontribut të hulumtuesve: Lavdim Bajraktari, Mirvet Thaçi dhe Leotrim Gashi

Ekipi redaktues: Betim Musliu, Ehat Miftaraj dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

Ky botim është produkt i projektit “Kërko Drejtësi: Fuqizimi i qasjes në drejtësi në Kosovë”, i cili mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan përmes Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe zbatohet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi –IKD në partneritet me Iniciativa për Progres –INPO.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:

Shtator, 2020

Prishtinë, Republika e Kosovës



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Lista e shkurtesave

DÇA	Departamenti për Çështje Administrative
DKR	Departamenti për Krime të Rënda
GJA	Gjykata e Apelit
GjEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
GjTh	Gjykata Themelore
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KE	Këshilli i Evropës
KEDNj	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës

Përmbajtja

I. Përmbledhje ekzekutive.....	5
II. Metodologjia	7
III. Të drejtat e njeriut në Kushtetutën e Republikës së Kosovës	8
IV. Instrumentet ndërkombëtare kushtetuese në rendin juridik kosovar	9
V. Pozita e jurisprudencës së GjEDNj-së në rendin juridik kosovar.....	10
VI. Obligueshmëria dhe rëndësia e zbatimit të neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës nga gjyqësori.....	11
VII. Mos zbatimi i neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës nga gjykatat e Republikës së Kosovës	12
VIII. Vlerësimet e akterëve të sistemit të drejtësisë	23
IX. Përfundime.....	31
X. Rekomandime	34

I. Përmbledhje ekzekutive

Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në Kushtetutën e Republikës së Kosovës paraqet një rregull specifik, i cili rregull ka për qëllim të ndërtoj një kulturë të veçantë lidhur me mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, që nuk është specifike me vende të tjera në kontinentin e Evropës. Në përkufizimin kushtetues të shtetit thuhet se “*Republika e Kosovës ushtron autoritetin e saj bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj*”. Po ashtu, respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut përcaktohet edhe si vlerë e rendit kushtetues të Republikës së Kosovës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka “betonizuar” vetën sa i përket të drejtave dhe lirive të njeriut, duke bërë që në këtë pjesë, të pamundësohet edhe amandamentimi kushtetues.

Me qëllim të avancimit të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka konstitucionalizuar tetë (8) instrumente ndërkombëtare, njëra ndër to edhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj (*Tutje*: KEDNJ). Republika e Kosovës duke mos qenë pjesë e Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Evropës, nuk ka autoritet për të nënshkruar dhe ratifikuar instrumentet ndërkombëtare, përkatësisht nuk ka mundësi për të aderuar në këto instrumente ndërkombëtare. Në planin e jashtëm, zbatimi i këtyre instrumenteve ndërkombëtare nuk paraqet obligim juridik ndërkombëtar për Republikën e Kosovës. Por, obligueshmërinë e zbatimit dhe respektimit të këtyre instrumenteve ndërkombëtare, Kosova e ka përcaktuar me Kushtetutë, sipas të cilit akt, të njëjtave u ka dhënë zbatueshmëri të drejtpërdrejtë dhe prioritet në raport me të gjitha ligjet tjera.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka ndërtuar standardin ku të drejtat dhe liritë e njeriut në Kosovë, nga institucionet gjyqësore dhe administrative interpretohen në *harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*. Respektivisht, në bazë të këtij standardi të mishëruar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, institucionet publike gjatë zbatimit të ligjit, janë të obliguara që të interpretojnë dhe zbatojnë ligjin duke marr për bazë praktikën e ndërtuar nga GJEDNJ, e që nga monitorimi sistematik i IKD-së, del se një obligim i tillë zbatohet vetëm përjashtimisht.

Sa i përket aplikimit të KEDNJ-së (neni 22.2) dhe nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me qëllim të krijimit të një pasqyrë të përgjithshme mbi zbatimin dhe mos zbatimin e këtyre dy neneve kushtetuese, IKD ka analizuar gjithsej 209 aktgjykime. Këto aktgjykime, i përkasin të gjitha gjykatave, përfshirë edhe degët e tyre, dhe të gjitha natyrave të rasteve. Këto aktgjykime i përkasin periudhës kohore 2016-2019 dhe të njëjtat janë përzgjedhur në mënyrë rastësore nga lista e aktgjykimeve të publikuara nga ana e gjykatave në faqet e tyre zyrtare.

Gjetjet e IKD-së për këtë pjesë janë se vetëm në raste përjashtuese, gjykatat i referohen KEDNJ-së siç është përcaktuar në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe vendimeve të GJEDNJ-së. Përkatësisht, gjetjet e IKD-së për këtë pjesë dërgojnë në konkludimin se këto dy nene kushtetuese janë pothuajse të vdekura në praktikën e gjyqësorit të Republikës së Kosovës.

Nga 209 aktgjykime të analizuara, në vetëm 20 prej tyre është aplikuar KEDNj siç përcaktohet në nenin 22.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Shprehur në përqindje, neni 22.2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës është aplikuar në vetëm 9.56% të rasteve, derisa nuk është aplikuar në 90.43% të rasteve të tjera.

Gjendje më e mirë nuk është as sa i përket zbatimit të jurisprudencës së GjEDNj-së, përkatësisht nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Nga 209 aktgjykime të analizuara, gjykatat e Republikës së Kosovës në vetëm 19 raste kanë aplikuar vendimet e GjEDNj-së. Kthyer në përqindje, këto vendime janë aplikuar në vetëm 9.09% të rasteve, derisa nuk janë aplikuar në 90.90% të rasteve.

Në këtë drejtim, gjetjet e IKD-së dëshmojnë se sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës, 12 vjet hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vazhdon të mos aplikojë dy (2) prej neneve kryesore kushtetuese që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e njeriut, të garantuara me aktin më të lartë juridik në Republikën e Kosovës. IKD vlerëson se një statistikë e tillë duhet të trajtohet seriozisht nga ana e sistemit gjyqësor, para së gjithash për faktin se thjesht mos aplikimi i këtyre dy neneve kushtetuese nga institucionet që janë pothuajse më të thirrurat për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e njeriut, paraqet mos respektim të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Tutje, sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës duhet ta ketë parasysh rëndësinë që ky institucion ka në ndërtimin e një rendi juridik praktika e të cilit ndërtohet në respektimit e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe harmonizimin e rendit juridik kosovar me praktikën e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, e veçanërisht me KE-në.

Sa i përket ngritjes së përqindjes së aplikimit të këtyre dy neneve kushtetuese nga ana e gjykatave të Republikës së Kosovës, IKD konsideron se është e rëndësishme jetike që gjyqtarët të trajtohen në mënyrë meritore dhe profesionale për aplikimin e KEDNj-së sipas nenit 22 të Kushtetutës dhe vendimeve të GjEDNj-së sipas nenit 53 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, roli qëndror i takon Akademisë së Drejtësisë, derisa në këtë proces duhet të ketë rol pro aktiv edhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), në mënyrë që të ngritë aplikimin e këtyre dy (2) neneve në aktgjykimet e gjykatave të Republikës së Kosovës.

Me këtë rast, IKD shpreh shqetësim për mos aplikimin e KEDNj-së dhe jurisprudencën e GjEDNj-së nga ana e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës. Veçanërisht, IKD shpreh shqetësim me vdekjen e këtyre dy (2) neneve kushtetuese në zbatimin praktik në Gjykatën e Apelit, e cila sipas gjetjeve të IKD-së, nuk ka “thyer akullin”, pasi në asnjë vendim të analizuar, kjo gjykatë nuk ka aplikuar as KEDNj-në sipas nenit 22 dhe as jurisprudencën e GjEDNj-së sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

II. Metodologjia

IKD ka hyrë në vitin e shtatë (7) të monitorimit të sistemit të drejtësisë, përkatësisht të monitorimit të gjykatave, degëve të gjykatave, prokurorive, KGJK-së dhe KPK-së.

Monitorimi i IKD-së bëhet në baza ditore, ku IKD ka monitorues në secilën gjykatë dhe degë të gjykatave, të cilët monitorojnë nga afër rastet penale, civile, administrative etj.

Me këtë rast, fokusi i IKD-së është monitorimi i zbatimit të Kushtetutës, ligjeve, vendimeve të këshillave etj. nga sistemi gjyqësor dhe prokurorial.

Në këtë raport, IKD ka analizuar aplikimin dhe mos aplikimin e neneve 22.2 dhe 53 të Kushtetutës në Gjykatat e Republikës së Kosovës. Përkatësisht, analiza mëton të provojë nivelin e aplikimit të KEDNj-së të përcaktuar në nenin 22.2 të Kushtetutës dhe jurisprudencën e GjEDNj-së sipas nenit 53 të Kushtetutës nga ana e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Për të zhvilluar këtë analizë, IKD në këtë raport ka analizuar gjithsej 209 aktgjykime, të cilat aktgjykime i përkasin periudhës kohore 2016-2019. Në këtë numër të aktgjykimeve përfshihen aktgjykimet e të gjitha natyrave dhe të gjitha niveleve të gjykatave brenda sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës. Të gjitha këto aktgjykime janë përzgjedhur në mënyrë rastësore nga lista e aktgjykimeve të publikuara nga ana e gjykatave në ueb faqet e tyre zyrtare.

Analizimi i aplikimit të neneve 22.2 dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës nuk hynë në meritat e mënyrës së aplikimit të këtyre dy (2) neneve kushtetuese, përkatësisht nuk vlerëson aplikimin e duhur apo jo të duhur të këtyre dy (2) neneve kushtetuese, por vetëm aplikimin dhe mos aplikimin e të njëjtave.

Pas analizimit një për një të 209 aktgjykimeve, IKD ka ndërtuar gjetjet e detajuara mbi zbatimin e këtyre dy neneve kushtetuese nga ana e gjykatave të Republikës së Kosovës.

Pas kësaj, para publikimit të këtij raporti, këto gjetje u janë prezantuar të gjithë hisedarëve të sistemit të drejtësisë dhe të njëjtit për qëllime të këtij raporti janë intervistuar nga IKD, përgjigjet e të cilëve janë pjesë e këtij raporti.

Lidhur me temën e kësaj analizë, IKD mbi bazën e gjetjeve të ndërtuara nga një analizë e detajuar, ka paraqitur edhe vlerësimet dhe rekomandimet konkrete për secilin institucion.

III. Të drejtat e njeriut në Kushtetutën e Republikës së Kosovës

Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në Kushtetutën e Republikës së Kosovës paraqet një rregullim specifik, i cili rregullim paraqet edhe një specifikë të rendit kushtetues kosovar.

Madje, mbi mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, materializohet edhe pjesa tjetër e Kushtetutës dhe në këtë mënyrë, duhet të ndërtohen edhe ligjet, për të cilën arsye, mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore paraqitet si bazament i rendit juridik kosovar.

Kjo kategori kushtetuese proklamohet në preambulën e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe i është dhënë një përcaktim kryesor edhe në dispozitat themelore të përcaktuara në kapitullin I të Kushtetutës.

Në përkufizimin kushtetues të shtetit thuhet se *“Republika e Kosovës ushtron autoritetin e saj bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj”*¹.

Po ashtu, respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut përcaktohet edhe si vlerë e rendit Kushtetues të Republikës së Kosovës².

Edhe sa i përket volumit, Kushtetuta e Kosovës më së shumti nene ka paraparë në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Në kapitullin II të Kushtetutës, janë përcaktuar gjithsej 36 nene që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e njeriut.

Për më tepër, Kushtetuta paraqet një rregullim specifik të të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, të cilës kategori i ka kushtuar një kapitull të veçantë (Kapitulli III) me gjithsej gjashtë (6) nene.

Për më tepër, Kushtetuta e Kosovës e ka “betonizuar” vetën sa i përket të drejtave dhe lirive të njeriut, duke bërë që lidhur me këtë kategori të normave kushtetuese të pamundësohet edhe amandamenti kushtetues.

Neni 144.3 i Kushtetutës përcakton se *“Ndryshimet në këtë Kushtetutë mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi të ketë adresuar Kryetari i Kuvendit të Kosovës amendamentin e propozuar në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar paraprakisht nëse ndryshimi i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës”*.

Pra, në këtë mënyrë, Kushtetuta e Kosovës ka përcaktuar se bazamenti i ndërtimit të rendit juridik kosovar është mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore, të cilat të drejta dhe liri as nuk mund të amendamentohen, si dhe të njëjtat duhet të respektohen dhe mbrohen nga secili institucion publik. Thënë më ndryshe, çdo mos respektim i një të drejte apo liri të njeriut

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 1.2.

² Po aty. Neni 7.1.

paraqet edhe mos respektim të Kushtetutës, përkatësisht dispozitave bazë mbi të cilat ndërtohet pjesa tjetër e Kushtetutës dhe në rendi juridik kosovar në përgjithësi.

IV. Instrumentet ndërkombëtare kushtetuese në rendin juridik kosovar

Me qëllim të avancimit të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka konstitucionalizuar tetë (8) instrumente ndërkombëtare.

Republika e Kosovës duke mos qenë pjesë e Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Evropës, nuk ka autoritet dhe mundësi për të nënshkruar dhe ratifikuar, përkatësisht aderuar në këto instrumente ndërkombëtare. Në planin e jashtëm, zbatimi i këtyre instrumenteve ndërkombëtare nuk paraqet obligim juridik ndërkombëtar për Republikën e Kosovës.

Por, obligueshmërinë e zbatimit dhe respektimit të këtyre instrumenteve ndërkombëtare Republika e Kosovës e ka përcaktuar në mënyrë të një anshme me Kushtetutë, sipas të cilit akt, të njëjtave u ka dhënë zbatueshmëri të drejtpërdrejtë dhe prioritet në raport me të gjitha ligjet tjera, duke mishëruar në rendin e saj kushtetues vlerat dhe standardet më të lartë për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

Në këtë drejtim, neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se:

*“Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, **garantohen** me këtë Kushtetutë, **zbatohen drejtpërdrejtë** në Republikën e Kosovës dhe kanë **prioritet**, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:*

- (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;*
- (2) **Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;***
- (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;*
- (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;*
- (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;*
- (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;*
- (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;*
- (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese”.*

Sipas këtij neni, këto tetë (8) instrumente ndërkombëtare duhet të zbatohen drejtpërdrejtë në rendin juridik kosovar. Pra, në këtë rast, zbatohet vetë instrumenti ndërkombëtar si i tillë dhe nuk referohet në ndonjë instrument tjetër.

Madje, sipas këtij neni, nëse ndonjë nga ligjet e Republikës së Kosovës ka konflikt me dispozitat e përcaktuara në këto instrumente ndërkombëtare, përparësi në zbatim kanë këto të fundit.

Në këtë mënyrë, Kushtetuta e Republikës së Kosovës obligon zbatimin e këtyre instrumenteve ndërkombëtare në secilin rast, pa marrë parasysh se për cilin pushtet bëhet fjalë.

V. Pozita e jurisprudencës së GjEDNj-së në rendin juridik kosovar

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përcaktuar një pikë reference me rastin e interpretimit të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Thënë më ndryshe, përderisa të drejtat dhe liritë e njeriut janë garantuar si nga norma kushtetuese ashtu edhe nga instrumentet ndërkombëtare si në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në po këtë kushtetutë është përcaktuar edhe mënyra se si këto të drejta duhet të interpretohen në praktikë.

Me këtë rast, si pikë referencë paraqitet jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në këtë drejtim, neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se:

“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

GjEDNj në kuadër të fushëveprimtarisë së saj, me vendimet që ka nxjerrë, ka strukturuar përmbajtjen e të drejtave të përcaktuara me KEDNj, me ç’ rast për secilën të drejtë dhe liri të njeriut, ka përcaktuar përmbajtjen, shtrirjen, ka vendosur standarde etj.

Në këtë mënyrë, në përputhje me nenin 53 të Kushtetutës së Kosovës, secili institucion publik duhet që të zbatojë të drejtat e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë dhe instrumentet ndërkombëtare të përcaktuara me nenin 22 të Kushtetutës, derisa interpretimi i këtyre të drejtave duhet të bëhet sipas shtrirjes, përmbajtjes dhe standardeve të vendosura nga jurisprudenca e GjEDNj-së.

Sa i përket kësaj dispozite, fillimisht e njëjta ndihmon jashtëzakonisht shumë rendin juridik kosovar në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Republika e Kosovës ka një rend relativisht të ri juridik dhe pasurimi i praktikës gjyqësore do merrte relativisht një kohë të gjatë. Në këtë mënyrë, me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, rendi juridik kosovar ka përvetësuar gjithë jurisprudencën e GjEDNj-së, pasi standardet e ndërtuara nga kjo gjykatë, tanimë janë drejtpërdrejtë të aplikueshme në rendin juridik kosovar.

Në anën tjetër, një nen i tillë lidhet edhe me aspiratën e Republikës së Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës, i cili anëtarësim automatikisht u jep të drejtë qytetarëve të Republikës së Kosovës që pas shterimit të mjeteve të brendshme juridike, ti drejtohen edhe GjEDNj-së.

Nëse do të aplikohet neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i bie se rendi juridik kosovar do të para përshtatej me standardet e GjEDNj-së, përkatësisht standardet e KE-së në fushën e të drejtave dhe lirive të njeriut, dhe do të ishte plotësisht e gatshme për anëtarësim në këtë organizatë ndërkombëtare.

VI. Obligueshmëria dhe rëndësia e zbatimit të neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës nga gjyqësori

Para së gjithash, aplikimi i këtyre dy neneve kushtetuese, ashtu si edhe të normave të tjera kushtetuese nga ana e institucioneve publike, në rastin konkret sistemit gjyqësor, paraqet obligueshmërinë më të lartë juridike në rendin juridik kosovar.

Kjo pasi që një obligim i tillë rrjedhë nga akti më i lartë juridik, Kushtetuta. Neni 16.1. i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se *“Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës...”*.

Në anën tjetër, detyrueshmëria e sistemit gjyqësor për respektimin e Kushtetutës është detyrimi bazë i këtij sistemi. Neni 102.3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se *“Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit”*.

Në këtë mënyrë, para së gjithash, mos zbatimi i këtyre normave kushtetuese, në rastin konkret neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, paraqet mos aplikim të aktit më të lartë juridik nga pushteti më i thirrur për ta bërë këtë, ai gjyqësor.

Tutje, sa i përket të drejtave dhe lirive të njeriut, norma kushtetuese e ka para harmonizuar praktikën gjyqësore, për arsye se ka referuar në një praktikë gjyqësore të konsoliduar dhe harmonizuar, siç është ajo e GjEDNj-së.

Në këtë mënyrë, përkundër faktit se legjislacioni i Republikës së Kosovës është relativisht i harmonizuar me instrumentet e caktuara ndërkombëtare dhe veçanërisht me KEDNj-në, teksti i këtyre normave juridike është i më i përgjithshëm dhe detajizimi është bërë nga ana e jurisprudencës së GjEDNj-së.

Duke përcaktuar si pikë obligative referimi jurisprudencën e GjEDNj-së përmes neni 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, qëllimi i Kushtetutës ka qenë që në rendin juridik kosovar, të drejtat e njeriut të interpretohen dhe zbatohen ashtu siç është përcaktuar në vendimet e GjEDNj-së. Andaj, mos referimi në këtë jurisprudencë me rastin e interpretimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, i cili interpretim është i domosdoshëm në secilën procedurë, dërgon në një interpretim të normës kushtetuese, jashtë interpretimit të cilin e ka synuar vetë Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Tutje, interpretimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore duke aplikuar instrumentet ndërkombëtare të përcaktuara në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, veçanërisht duke zbatuar KEDNJ-në, do ta para përgatiste Republikën e Kosovës për anëtarësim në organizata të ndryshme ndërkombëtare. Veçanërisht, aplikimi i nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës do ta përgatiste rendin juridik kosovar për anëtarësim në KE.

Madje, nisur nga fakti se këto instrumente ndërkombëtare kanë epërsi ndaj të gjitha ligjeve vendore, gjyqësori i Republikës së Kosovës do të luante edhe rolin e kontrollimit të legjislacionit, nëse i njëjti është në harmoni me këto instrumente ndërkombëtare. Kjo pasi që, nëse një ligj i caktuar nuk do të ishte në harmoni me këto instrumente, atëherë i njëjti do të përjashtohej nga zbatimi, pasi gjykata kompetente nuk do ta zbatonte ligjin në fjalë, por instrumentin ndërkombëtar respektiv.

VII. Mos zbatimi i neneve 22.2 dhe 53 të Kushtetutës nga gjykatat e Republikës së Kosovës

IKD tash e disa vite monitoron në mënyrë sistematike, sistemin e drejtësisë në Kosovë. Ky monitorim shtrihet që nga monitorimi i KGJK-së dhe KPK-së, e deri tek prokuroritë, gjykatat dhe degët e gjykatave, qeverinë dhe agjencitë e tjera që zbatojnë ligjin në Kosovë.

Gjatë procesit të monitorimit, IKD një trajtim të veçantë i kushton zbatimit të obligimeve kushtetuese dhe ligjore nga ana e sistemit të drejtësisë por edhe të organeve tjera publike që marrin vendime administrative.

Sa i përket aplikimit të KEDNJ-së sipas nenit 22.2 dhe jurisprudencës së GjEDNJ-së sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me qëllim të krijimit të një pasqyrë të përgjithshme mbi zbatimin dhe mos zbatimin e këtyre dy neneve kushtetuese, IKD ka analizuar gjithsej 209 aktgjykime.

Këto aktgjykime, i përkasin të gjitha gjykatave, përfshirë edhe degët e tyre, dhe të gjitha natyrave të rasteve. Këto aktgjykime i përkasin periudhës kohore 2016-2019 dhe të njëjtat janë përzgjedhur në mënyrë rastësore nga lista e aktgjykimeve të publikuara nga ana e gjykatave në ueb faqet e tyre zyrtare.

Gjykata	Numri i aktgjykimeve të analizuara
Gjykata Supreme	20
Gjykata e Apelit	30
GjTh Prishtinë	105
GjTh Prizren	9
GjTh Pejë	9
GjTh Gjilan	9
GjTh Gjakovë	9
GjTh Mitrovicë	9
GjTh Ferizaj	9
Total	209

Tabela 1 – Numri i aktgjykimeve të analizuara në të gjitha gjykatat në Kosovë.

Në këto aktgjykime, IKD ka analizuar aplikimin e KEDNj-së sipas nenin 22.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe aplikimin jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjetjet e IKD-së për këtë pjesë janë se vetëm në raste përjashtuese, gjykatat i referohen KEDNj-së dhe vendimeve të GjEDNj-së. Përkatësisht, gjetjet e IKD-së për këtë pjesë dërgojnë në konkludimin se këto dy nene kushtetuese janë pothuajse të “vdekura” në praktikën e gjyqësorit të Republikës së Kosovës.

IKD nga monitorimi praktik i punës së gjykatave gjen se zbatuesit e ligjit në sistemin e drejtësisë në Kosovë, nuk kanë njohuritë dhe ekspertizën e mjaftueshme për të ndjekur dhe zbatuar dispozitat kushtetuese dhe jurisprudencën e GJEDNJ, lidhur me të drejtat dhe liritë e njeriut.

Nga 209 aktgjykime, në vetëm 20 prej tyre është aplikuar KEDNj siç përcaktohet në nenin 22.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Shprehur në përqindje, neni 22.2 i Kushtetutës së Kosovës është aplikuar në vetëm 9.56% të rasteve, derisa nuk është aplikuar në 90.43% të rasteve të tjera.

Numri i aktgjykimeve të analizuara	Numri i rasteve kur është aplikuar KEDNj	Përqindja e aplikimit të KEDNj	Përqindja e mos aplikimit të KEDNj
209	20	9.56%	90.43%

Tabela 2 – Përqindja e aplikimit të nenit 22.2 të Kushtetutës në aktgjykimet e analizuara.

Gjendje më e mirë nuk është as sa i përket zbatimit të jurisprudencës së GjEDNj-së, përkatësisht nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Nga 209 aktgjykime të analizuara, gjykatat e Republikës së Kosovës në vetëm 19 raste kanë aplikuar vendimet e GjEDNj-së. Kthyer në përqindje, këto vendime janë aplikuar në vetëm 9.09% të rasteve, derisa nuk janë aplikuar në 90.90% të rasteve.

Numri i aktgjykimeve të analizuara	Numri i rasteve kur është aplikuar neni 53 të Kushtetutës	Përqindja e aplikimit të nenit 53 të Kushtetutës	Përqindja e mos aplikimit të nenit 53 të Kushtetutës
209	19	9.09%	90.90%

Tabela 3 – Përqindja e aplikimit të nenit 53 të Kushtetutës në aktgjykimet e analizuara.

Në këtë drejtim, gjetjet e IKD-së dëshmojnë se sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës, 12 vjet hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vazhdon të mos aplikojë dy (2) prej neneve kryesore kushtetuese që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e njeriut, të garantuara me aktin më të lartë juridik në Republikën e Kosovës.

Fillimisht, IKD vlerëson se një statistikë e tillë duhet të trajtohet seriozisht nga ana e sistemit gjyqësor, para së gjithash për faktin se thjesht mos aplikimi i këtyre dy neneve kushtetuese (22.2 dhe 53) nga institucionet që janë pothuajse më të thirrurat për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e njeriut, paraqet mos respektim të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Tutje, sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës duhet ta ketë parasysh rëndësinë që ky institucion ka në ndërtimin e një rendi juridik praktika e të cilit ndërtohet në respektimit e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe harmonizimin e rendit juridik kosovar me praktikën e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, e veçanërisht me KE-në.

Sa i përket ngritjes së përqindjes së aplikimit të këtyre dy neneve kushtetuese nga ana e Gjykatave të Republikës së Kosovës, IKD konsideron se është e rëndësishme jetike që gjyqtarët të trajtohen në mënyrë meritore dhe profesionale për aplikimin e KEDNj-së sipas nenit 22.2 të Kushtetutës dhe vendimeve të GjEDNj-së sipas nenit 53 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, roli qendror i takon Akademisë së Drejtësisë, derisa në këtë proces duhet të ketë rol pro aktiv

edhe KGJK, në mënyrë që të ngritë zbatimin e këtyre dy (2) neneve në aktgjykimet e gjykatave të Republikës së Kosovës.

Sa i përket aplikimit të këtyre dy (2) neneve kushtetuese sipas gjykatave, në aplikimin e KEDNj-së të përcaktuar në nenin 22.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës prin Gjykata Supreme me pesë (5) raste, apo 25% të aktgjykimeve të analizuara të kësaj gjyakte, pasuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë me 15 raste apo 14.28% e aktgjykimeve të analizuar të kësaj gjykatë.

Gjykata	Numri i aktgjykimeve analizuara	Numri i aktgjykimeve të cilat është aplikuar KEDNj	Përqindja e zbatimit të KEDNj
Gjykata Supreme	20	5	25%
Gjykata e Apelit	30	0	0%
GjTh Prishtinë	105	15	14.28%
GjTh Prizren	9	0	0%
GjTh Pejë	9	0	0%
GjTh Gjilan	9	0	0%
GjTh Gjakovë	9	0	0%
GjTh Mitrovicë	9	0	0%
GjTh Ferizaj	9	0	0%

Tabela 4 – Aplikimi i nenit 22.2 të Kushtetutës, sipas gjykatave.

Ndërsa, sa i përket aplikimit të vendimeve të GjEDNj-së sipas Gjykatave, në aplikimin e këtyre vendimeve sipas nenit 53 të Kushtetutës prin Gjykata Themelore në Prishtinë me 15.23% të rasteve të analizuara, pasuar nga Gjykata Supreme me 15% të rasteve të analizuara, derisa asnjë gjykatë tjetër në asnjë rast të analizuar nuk ka aplikuar ndonjë vendim të GjEDNj-së, sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata	Numri i aktgjykimeve të analizuara	Numri i aktgjykimeve të cilat është aplikuar në 53 Kushtetutës	Përqindja e zbatimit të nenit 53 të Kushtetutës
Gjykata Supreme	20	3	15%
Gjykata e Apelit	30	0	0%
GjTh Prishtinë	105	16	15.23%
GjTh Prizren	9	0	0%
GjTh Pejë	9	0	0%
GjTh Gjilan	9	0	0%
GjTh Gjakovë	9	0	0%
GjTh Mitrovicë	9	0	0%
GjTh Ferizaj	9	0	0%

Tabela 5 – Aplikimi i nenit 53 të Kushtetutës, sipas gjykatave.

Në anën tjetër, IKD ka analizuar edhe shkallën e aplikimit dhe mos aplikimit të nenit 22.2 dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës sipas natyrës së rasteve në të cilat bëjnë pjesë aktgjykimet e analizuara. Përkatësisht, kjo analizë ka të bëjë me shkallën e aplikimit dhe mos aplikimit të këtyre dy (2) neneve kushtetuese sipas departamenteve dhe divizioneve të gjykatave. Meqenëse, Gjykata Supreme nuk është e profilizuar në departamente, kjo analizë është bërë vetëm për Gjykatat Themelore dhe Gjykatën e Apelit.

Sa i përket aplikimit të nenit 22.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, përqindja është minimale pothuajse në të gjitha fushat, përjashtimisht Departamentit për Çështje Administrative të GjTh në Prishtinë dhe Departamenteve për të Mitur të GjTh-ve.

Në këtë rast, me aplikimin e KEDNj siç përcaktohet në nenin 22.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, prin Departamenti për Çështja Administrative i Gjykatës Themelore në Prishtinë, me 28% të rasteve të analizuara.

Divizonet Penale të GjTh-ve dhe Departamenti për Çështje Ekonomike i GjTh në Prishtinë nuk kanë aplikuar këtë nen në asnjë rast. Po ashtu, as Gjykata e Apelit duke përfshirë të gjitha departamentet e saj, nuk e kanë zbatuar këtë nen të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Niveli i gjykatës	Departamenti/Divizioni	Numri i aktgjykimeve të analizuara	Numri i aktgjykimeve në të cilat është aplikuar KEDNj	Përqindja e zbatimit të KEDNj
Themelore	Divizioni Civil	30	3	10%
Themelore	Divizioni Penal	23	0	0%
Themelore	Departamenti për Krime të Rënda	34	4	11.76%
Themelore	Departamenti për të Mitur	5	0	0%
Themelore	Departamenti Special	17	1	5.88 %
Themelore	Departamenti për Çështje Administrative	25	7	28%
Themelore	Departamenti për Çështje Ekonomike	25	0	0%
Apel	Divizioni Civil	5	0	0%
Apel	Divizioni Penal	5	0	0%
Apel	Departamenti për Krime të Rënda	5	0	0%
Apel	Departamenti për të Mitur	5	0	0%
Apel	Departamenti Special	5	0	0%
Apel	Departamenti për Çështje Administrative	5	0	0%
Apel	Departamenti për Çështje Ekonomike	5	0	0%

Tabela 6 – Aplikimi i nenit 22.2 të Kushtetutës, sipas departamenteve dhe divizioneve të gjykatave.

Gjendje pothuajse e njëjtë është edhe sa i përket aplikimit të vendimeve të GjEDNj-it nga ana e departamenteve përkatëse. Në këtë rast, në aplikimin e jurisprudencës së GjEDNj-it në aktgjykimet përkatëse sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës prin përsëri DÇA i GjTh në Prishtinë me 32% të aktgjykimeve të analizuara, pasuar nga DKR-të e GjTh-

ve me 11.76% të aktgjykimeve të analizuara, divizionet civile të GjTh-ve me 10% të aktgjykimeve të analizuara dhe DS i GjTh në Prishtinë me 5.88% të aktgjykimeve të analizuara.

Ky nen i Kushtetutës së Republikës së Kosovës nuk është aplikuar në asnjë rast nga divizionet penale të GjTh-ve, Departamentet për Mitur të GjTh-ve dhe Departamenti për Çështje Ekonomike i GjTh në Prishtinë. Po ashtu, ky nen kushtetues nuk është aplikuar në asnjë rast nga asnjë departament i GjA-së.

Niveli i gjykatës	Departamenti/Divizioni	Numri i aktgjykimeve të analizuara	Numri i aktgjykimeve në të cilat është aplikuar neni 53 i Kushtetutës	Përqindja e zbatimit të nenit 53 të Kushtetutës
Themelore	Divizioni Civil	30	3	10%
Themelore	Divizioni Penal	23	0	0%
Themelore	Departamenti për Krime të Rënda	34	4	11.76%
Themelore	Departamenti për të Mitur	5	0	0%
Themelore	Departamenti Special	17	1	5.88 %
Themelore	Departamenti për Çështje Administrative	25	8	32%
Themelore	Departamenti për Çështje Ekonomike	25	0	0%
Apel	Divizioni Civil	5	0	0%
Apel	Divizioni Penal	5	0	0%
Apel	Departamenti për Krime të Rënda	5	0	0%
Apel	Departamenti për të Mitur	5	0	0%
Apel	Departamenti Special	5	0	0%
Apel	Departamenti për Çështje Administrative	5	0	0%
Apel	Departamenti për Çështje Ekonomike	5	0	0%

Tabela 7 – Aplikimi i nenit 53 të Kushtetutës, sipas departamenteve dhe divizioneve të gjykatave.

Tutje, IKD ka analizuar edhe aplikimin e neneve 22.2 dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës nga ana e gjykatave sipas nivelit të gjykatave.

Në këtë drejtim, nga 209 aktgjykimet e analizuar, përqindjen më të lartë të zbatimit të KEDNJ-së e ka Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës me 25% të aktgjykimeve të analizuar, pasuar nga Gjykatat Themelore me 9.43% të aktgjykimeve të analizuar, derisa ky nen i Kushtetutës së Republikës së Kosovës nuk është zbatuar në asnjë rast nga Gjykata e Apelit.

Niveli	Numri i aktgjykimeve analizuar	Numri i të cilat është aplikuar KEDNJ	Përqindja e aplikimit të KEDNJ
Gjykatat Themelore	159	15	9.43%
Gjykata e Apelit	30	0	0%
Gjykata Supreme	20	5	25%

Tabela 8 – Aplikimi i nenit 22.2 të Kushtetutës, sipas nivelit të gjykatave.

Ndërsa, në aplikimin e jurisprudencës së GjEDNJ-it sipas nenit 53 të Kushtetutës prin përsëri Gjykata Supreme me 15% të rasteve të analizuar, pasuar nga gjykatat themelore me 10.06% të rasteve të analizuar, derisa as këtë nen të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në asnjë rast nuk e ka zbatuar Gjykata e Apelit.

Niveli	Numri i aktgjykimeve analizuar	Numri i të cilat është aplikuar neni 53 i Kushtetutës	Përqindja e aplikimit të nenit 53 të Kushtetutës
Gjykatat Themelore	159	16	10.06%
Gjykata e Apelit	30	0	0%
Gjykata Supreme	20	3	15%

Tabela 9 – Aplikimi i nenit 53 të Kushtetutës, sipas niveleve të gjykatave.

Në këtë rast, IKD shpreh shqetësim për mos aplikimin e dy neneve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës nga ana e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës, nene këto kryesore në fushën e të drejtave dhe lirive kushtetuese të njeriut. Në këtë drejtim, përqindja e aplikimit të këtyre dy neneve kushtetuese nga Gjykata Supreme dhe Gjykatat Themelore paraqet vetëm përjashtim dhe kjo përqindje në asnjë rrethanë nuk paraqet as për së afërmi shkallë optimale të zbatimit të nenit 22.2 dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Për këtë arsye, angazhimi për të adresuar këtë dukuri në sistemin gjyqësor, duhet të fillojë pothuajse nga zero.

Por, situata edhe më keq qëndron në Gjykatën e Apelit. Në asnjë prej rasteve të analizuara në këtë raport, IKD nuk ka gjetur aplikim të KEDNj-së sipas nenit 22.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe as të ndonjë vendimi të GjEDNj-it sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Pra, këto dy nene kushtetuese janë nene inekzistente në punën e Gjykatës së Apelit.

Me këtë rast, IKD e vlerëson si shqetësuese këtë mos zbatim të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në rastin konkret nenit 22.2 të 53 të Kushtetutës, nga ana e Gjykatës së Apelit. Për më tepër, kjo Gjykatë, krahas Gjykatës Supreme, do të duhej të vendoste standarde për trajtimin e rasteve nën frymën dhe zbatimin e këtyre dy (2) neneve kushtetuese. Madje, e njëjta gjykatë do të mund edhe të ndryshonte apo të kthente në rivendosje rastet e gjykatave themelore, nëse të njëjtat bien në kundërshtim me KEDNj-në (neni 22.2 i Kushtetutës) apo vendimet e GjEDNj-së sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Për këtë arsye, IKD vlerëson se përkundër nivelit tejet të ulët të aplikimit të këtyre dy neneve kushtetuese, situata më e rëndë është në Gjykatën e Apelit, e cila sipas gjetjeve të IKD-së, nuk ka “thyer akullin” në zbatimin e këtyre dy (2) neneve kushtetuese.

Në tabelat në vijim, janë paraqitur numrat e lëndëve të 209 aktgjykimeve të cilat janë analizuar për këtë raport:

C.nr.606/18 P.nr.666/2019 C.nr.285/14 AA.nr.397/2019 PS.nr.2/20 PKR.nr.338/18 C.nr.1774/13 A.nr.1136/17

C.nr.52/15	C.nr.875/2015	PKR.nr.170/1	AA.nr.485/2019	PS.nr.16/20	PKR.nr.366/18	C.nr.158/07	A.nr.1183/17
C.nr.495/18	C.nr.1014/2018	P.nr. 61/17	AC.nr.3692/2013	PS.nr.56/2019	PKR.nr.235/18	C.nr.326/12	A.nr.1242/17
PKR.nr.141/16	C.nr.31/2018	P.nr.257/16	AC.nr.1218/15	PS.nr.43/19	PKR.nr.224/19	C. nr.595/17	A.nr.220/17
PKR. nr. 62/19	PKR. nr. 160/2014	P.nr.274/20	Ac.nr.2659/15	PS.nr.23/19	PKR.nr.819/2013	C.nr.2167/19	A.nr.312/17
PKR. 161/16	PKR.60/2019	PM.nr. 41/17	Ac.nr.722/18	PS.nr.38/19	PKR.nr.66/13	C.nr.394/2016	A.nr.1621/18
P.nr.73/19	PKR.nr.13/17	PM.nr.19/18	Ac.nr.1969/18	PS.nr.22/2019	PKR.nr.213/19	C.nr.631/14	A.nr.1849/18
1122/17	P.nr.603/16	C.nr.270/19	Ae.nr.215/17	PS.nr.63/19	PKR nr.42/18	C.nr.1331/17	A.nr.331/2017
P.nr. 86/2019	P.nr.441/19	C.nr.2003/2018	Ae.nr.181/2016	PS.nr.44/19	PKR.nr.629/2016	C.nr.2116/12	A.nr.378/17
C.nr.132/16	P.nr.36/2019	C. nr. 1490/2019	Ae.nr.17/2016	PS.nr.20/19	PKR.nr.250/2017	C.nr.383/2015	A.nr.1437/16
C.nr.465/2018	C.nr.339/2019	Pkr.nr.216/2016	Ae.nr.186/2016	PS.nr.65/2019	PKR.nr.259/2017	C. nr. 425/17	A.nr.2814/19
C.nr. 904/19	C.nr.692/2019	P.nr.41/2017	Ae.nr.69/18	PS.nr.9/2019	PKR. Nr. 383/09	C.nr.1914/16	A.nr.2963/18
PKR. nr. 59/15	C.nr.256/2007	PKR.nr.9/2020	PAKR.nr.631/15	PS.nr.78/19	PKR.nr.85/2014	EK.nr.331/19	A.nr.2122/17
PKR.nr.113/16	P.nr.25/2017	P.nr.981/2016	PAKR.nr.486/2017	PS.nr.73/2019	PKR.nr.717/13	III.EK.nr.535/19	A.nr.1473/18
PKR.nr.91/2020	P.nr.31/17	P.nr.1826/2017	PAKR.nr.89/2018	PS.nr.66/2019	P.nr.422/06	II.EK.nr.231/17	A.nr.1089/17
PKR.nr.356/2012	P.nr.87/2017	P.nr.1075/2018	PAKR.nr.341/2019	PS.nr.1/2020	PKR. nr.203/2017	III.EK.nr.492/19	

							A.nr.2610/18
P.nr.504/2019	P.nr.585/19	AA.nr.146/2016	PAKR.nr.14/20	PS.nr.18/20	P.nr.50/2020	V.EK.nr.423/18	A.nr.2716/2019
AA.-Uzh.nr.16/2017	P.nr.1021/2019	AA.nr.416/2016	PA1.nr.711/2016	III.EK.nr.565/2018	P.nr.2052/17	V.EK.nr.675/18	A.nr.1777/18
AA.-Uzh.nr.17/2017	P.nr.584/2019	AA.nr.510/2019	PA1.nr.720/2018	III.EK.nr.349/2018	P.nr.49/2020	III.EK.nr.113/18	A.nr.1540/17
PA-II.nr.1/2018	C.nr.973/19	Pml.nr.296/2017	PA1.nr.984/19	III.Ek.nr.103/2017	P. nr.119/18	V.EK.nr.374/18	A.nr.2088/18
C-IV-17-0044	C.nr. 1333/17	PML.nr.8/2018	PA1.nr.1408/2019	I.EK.nr.502/19	P.nr.2559/19	III.Ek.nr.569/2018	A.nr.1052/18
C-IV-17-0064	Pml.nr.113/2019	Pml.nr.230/2019	PA1.nr.172/20	I.EK.nr.562/15	P.nr.70/20	V.EK.nr.196/16	A.nr.1902/18
C-IV-13-1254	Rev.nr.454/2019	Pml.nr.145/2019	APS.nr.3/2020	APS.nr.2/2019	P.nr.3017/2019	I.EK.nr.381/2017	A.nr.1829/17
C-IV-13-1871	Rev.nr.3/2020	Pml.nr.58/2019	APS.nr.8/2020	APS.nr.11/2019	P.nr.2238/16	V.EK.nr.339/18	A.nr.2922/2019
C-IV-13-1377	Rev.nr.456/2019	Rev.nr.208/2019	V.EK.nr.47/17	APS.nr.4/2020	P.nr.1329/2016	V.Ek.nr.4/2018	A.nr.253/2018
III.Ek.nr.331/2018	Rev.E.nr.22/2017	V.EK.nr.550/15	III.Ek.nr.431/2019	III.Ek.nr.359/2019	P.nr.485/2019	V.EK.nr.303/2018	V.EK.nr.252/18
E.Rev.n							

Tabela 10 – Numrat e aktgjytimeve të analizuara për këtë raport.

VIII. Vlerësimet e akterëve të sistemit të drejtësisë

Pas zhvillimit të hulumtimit nga IKD dhe gjetjeve se aplikimi i nenit 22.2 dhe 53 të Kushtetutës nga gjyqësori në Kosovë, nuk e kalon as nivelin prej 10 %, IKD ka zhvilluar edhe disa intervista me akterë të sistemit të drejtësisë në Kosovë, lidhur me këtë problematikë.

Intervistat janë zhvilluar me krerët e gjykatave në Kosovë, prokurorë, avokatë, Akademinë e Drejtësisë, Institucionin e Avokatit të Popullit si dhe profesorë të fakultetit juridik në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Akterët e intervistuar e kanë vlerësuar si të rëndësishëm dhe të nevojshëm për sistemin e drejtësisë, hulumtimin e kryer nga IKD duke ndarë të njëjtin mendim edhe me gjetjet që ka bërë IKD për këtë problematikë.

Lidhur me zbatimin e nenit 22.2 të Kushtetutës, Kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci, ka vlerësuar se nëse në aktgjykimet e gjykatave vendore janë zbatuar ligjet vendore por që nuk kanë qenë në kundërshtim me instrumentet ndërkombëtare, atëherë sipas tij, jo domosdoshmërisht, gjykatat duhet t'iu referohen edhe instrumenteve ndërkombëtare.

Po ashtu, Peci ka thënë se lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave kushtetuese, sistemi gjyqësor ka mbajtur trajnime, ndërsa Gjykata Supreme e Kosovës në bashkëpunim me Gjykatën Kushtetuese, në të kaluarën bashkërisht i kanë diskutuar problemet praktike që i ka në sistemi gjyqësor pasi që siç ka thënë, Gjykata Kushtetuese edhe në shumë raste ka vendos lidhur me kërkesat e palëve që kanë pretenduar në shkeljen e të drejtave të njeriut, bazuar në instrumentet ndërkombëtare.

Ndërsa, Kryetari i Gjykatës së Apelit, Hasan Shala ka ndarë të njëjtin mendim me gjetjet e IKD-së, duke thënë se në shumicën e rasteve, gjyqtarët nuk i zbatojnë këto dispozita kushtetuese në aktgjykimet e tyre.

Sipas tij, shumica e ligjeve të cilat zbatohen nga gjyqësori në Kosovë, janë në përputhje me konventat ndërkombëtare prandaj sipas tij, gjyqtarët e kanë krijuar zakonin që të thirren drejtpërdrejtë në ligje e jo në konventa ndërkombëtare.

Sipas Shalës, lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave janë bërë shumë trajnime, ndërsa faktin se instrumentet ndërkombëtare nuk përmenden specifikisht në aktgjykime, kryetari i Apelit e ka quajtur si një formalitet shumë të vogël.

Si reale dhe që pasqyrojnë drejtë aplikimin e neneve 22 dhe 53, e ka vlerësuar raportin e IKD-së, Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Afërdita Bytyçi.

Sipas Bytyçit, gjyqësori në Kosovë ka bërë disa hapa progresiv në aplikimin e jurisprudencës së GjEDNJ-it.

“Është evidente që në si Gjykatë Themelore në Prishtinë jemi në hapat fillestar të aplikimit të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por po ashtu është evidente se kemi bërë disa hapa progresiv në këtë aspekt dhe jemi plotësisht të vetëdijshëm se në proceset integruese që e presin Republikën e Kosovës, roli i gjykatave si komponentë e përmbushjes së standardeve ndërkombëtare të sundimit të ligjit dhe respektimit të drejtave të njeriut është bazik, andaj, për këtë qëllim ne vetëm se kemi filluar me aplikimin e këtyre neneve në masën siç e thekson raporti juaj dhe mbetet në të ardhmen që kjo përqindje të rritet, si rrjedhë e natyrshme e proceseve integruese, pasi që qytetarët tanë do të kenë mundësi që t'i drejtohen edhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me jurisprudencën të së cilës në duhet që të jemi në harmoni” – thuhet në përgjigjen e Bytyçit për IKD-në.

Sipas kryetares së GjTh në Prishtinë, nuk ka pengesa për aplikimin e këtyre neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës dhe se gjyqtarët e GjTh Prishtinë sipas saj janë të trajnuar në aplikimin e këtyre neneve dhe lidhur me këtë kontribut sipas saj ka dhënë Akademia e Drejtësisë së Kosovës, por edhe në kolegjiunin e gjykatës janë shtruar për diskutim këto çështje.

Kurse, Kryetari i Gjykatës Themelore në Pejë, Armend Berisha, ka thënë në intervistën e dhënë për IKD, se marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare të cilat garantojnë të Drejtat dhe Lirit Themelore të Njeriut, garantojnë vetëm minimumin e të drejtave ndërkohe që sipas tij, legjislacioni ynë është shumë me i avancuar në këtë drejtim pasi që të gjitha ligjet të cilat janë në zbatim në Republikën e Kosovës janë në harmoni të plotë me aktet dhe instrumentet ndërkombëtare që garantojnë Lirit dhe të Drejtat e Njeriut madje në disa raste edhe i tejkalojnë.

Sipas Berishës, i gjithë legjislacioni ynë është po ashtu në harmoni me Kushtetutën e Kosovës, andaj edhe vendimet gjyqësor nuk kanë se si të jenë ndryshe.

“Mund të ketë raste te caktuara ku gjyqtaret edhe mund ti shmangen të lartë përmendurave por nuk është ne kompetencën time as ti mësoj aq me pak t’ju bej presion ne krijimin e bindjes, janë organet tjera qe merren me këto çështje dhe vlen te theksohet se një nga indikatorët matës te vlerësimit te performances se gjyqtareve është edhe referimi ne rastet e Gjykatës për Mbrojtjen e Drejtave dhe Lirive te Njeriut, me seli në Strasburg” – ka thënë Berisha.

Sipas Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Nikollë Komani, nëse gjyqtarët do të zbatojnë me përpikëri dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, atëherë i bie që do të respektohen edhe dispozitat 22 dhe 53 të Kushtetutës. Kjo pasi sipas tij, në legjislacionin vendor janë të inkorporuar edhe këto parime bazë të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saja.

Sa i përket përqindjes së ulët të përdorimit të neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës në aktgjykimet e gjyqtarëve, Komani ka thënë se nuk ka ndonjë koment të veçantë, veçse ka theksuar se nuk duhet të ketë pengesa për zbatimin e këtyre dispozitave kushtetuese, përkundrazi, sipas tij, është obligim zbatimi i tyre.

“Po ashtu, sa i përket trajnimeve, sa unë kam njohuri në Akademinë e Drejtësisë organizohen trajnime të veçanta për Konventën Evropiane, ndërsa nuk jam në dijeni te ketë pasur trajnime të veçanta vetëm sa i përket këtyre dy neneve të Kushtetutës, mirëpo ndaj mendimin që çfarëdo trajnimi shtesë me qëllim të zbatimit dhe aplikimit të dispozitave kushtetuese me rastin e përpilimit të aktgjykimeve është i dobishëm dhe do të ndikonte jo vetëm në ngritjen e profesionalizmit por edhe rritjen e besimit të publikut në punën e gjyqësorit” – ka thënë ndër të tjera, Komani.

Ngjashëm sikurse edhe krerët tjerë të gjykatave, edhe ushtruesi i detyrës së Kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren, Artan Sejrani, ka thënë se në legjislacionin vendor janë të

inkorporuar dispozitat 22 dhe 53 të Kushtetutës, andaj sipas tij, nëse zbatohet në mënyrë të përpiktë Kodi i Procedurës Penale, atëherë fakti se nuk ceken nenet në fjalë në aktgjykime, nuk paraqet ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut.

Po ashtu, Sejrani ka thënë se nuk ka ndonjë pengesë në mos aplikimin e këtyre dispozitave kushtetuese, duke shtuar se në rastet kur ka ndonjë paqartësi, gjykatat mund të zbatojnë dispozitat e nenit 22 dhe 53 të Kushtetutës. Për më tepër, Sejrani ka theksuar se gjyqtarët e Prizrenit, vazhdimisht marrin pjesë në trajnime, atëherë kur ato mbahen lidhur me këtë problematikë, kurse, në kolegjiomet e GjTh së Prizrenit, Sejrani ka thënë se nuk është diskutuar kjo problematikë ndonjëherë.

Gjetjet e IKD-së për mos zbatimin e neneve 22 dhe 53, si të drejta i ka vlerësuar, Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan, Ramiz Azizi. Sipas tij, nuk ka ndonjë pengesë në përdorimin e këtyre dispozitave në aktgjykimet e gjykatave, mirëpo, një gjë e tillë vjen kryesisht nga neglizhenca e gjyqtarëve.

Lidhur me këtë problematikë, Azizi ka thënë se është diskutuar edhe në kolegjiome të gjyqtarëve dhe seminare të ndryshëm, për çka ka premtuar se do të vazhdojë edhe në kolegjiomet e ardhshme me gjyqtarë të Gjilanit.

Ndërsa, prokurori në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, ka thënë se gjetjet e IKD-së, dëshmojnë se gjyqtarët në Kosovë janë të fokusuar vetëm në zbatimin e legjislacionit primar, ndërsa nuk shfrytëzohen dispozitat 22 dhe 53 të Kushtetutës. Një gjë e tillë, Kelmendi e ka quajtur mungesë të traditës së praktikës gjyqësore për zbatim edhe të dispozitave të instrumenteve ndërkombëtare.

Sipas Kelmendit, nuk ka ndonjë pengesë në zbatimin e këtyre dispozitave, përveç se sipas tij, duhet vullnet, përkushtim dhe njohuri të këtyre instrumenteve ndërkombëtare.

Prokurori Kelmendi ka thënë në intervistën e tij për IKD, se sa ka njohuri ai, problematika e zbatimit të neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës, nuk është diskutuar në kolegjiomet e prokurorëve siç ka thënë se nuk ka njohuri se ka pasur trajnim specifik për këto dy nene.

Lidhur me këtë problematikë, IKD ka intervistuar edhe avokatin Artan Qerkini. Sipas tij, mos aplikimi i neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës vjen nga së paku dy arsye.

“Së pari, tek gjyqtarët është krijuar bindja se ata duhet të zbatojnë ligjin, e jo edhe Kushtetutën duke menduar se dispozitat kushtetuese duhet te zbatohen vetëm nga Gjykata Kushtetuese. Mendoj, se një qëndrim i tillë bie ndesh me Ligjin per Gjykatat, sipas të cilit gjykata duhet të gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe Ligjit. Se dyti, gjykatat janë të stërngarkuara me numër të madh të lëndëve dhe për këtë arsye gjyqtarët nuk kanë apo kanë fare pak kohë që të familjarizohen me praktikën e GJEDNJ-së.” – ka thënë Qerkini.

Duke parë praktikën e tilë të gjykatave, avokati Qerkini ka thënë se edhe vet ai si avokat, kohëve të fundi gjithnjë e më pak po i referohet praktikës së aplikimit të dispozitave të

neneve 22 dhe 53 në raport me gjykatat e rregullta. Ndërsa, në një masë më të madhe, një gjë të tillë, Qerkini ka thënë se e bën në rastet të cilat i paraqet në Gjykatën Kushtetuese.

Gjithashtu, Qerkini ka thënë se gjetjet e këtij raporti të IKD-së janë të sakta, duke shtuar se gjyqtarët duhet të kenë trajnime të vecanta në lidhje me jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut sa i përket neneve 6,7,8,9,10,11,12 dhe 13 të KEDNJ-së. Për më tepër, Qerkini ka theksuar se me këtë problematikë nuk përballen vetëm gjyqtarët por edhe prokurorët e avokatët.

Duke vlerësuar angazhimin e IKD-së për hulumtimin e bërë, nga Akademia e Drejtësisë kanë thënë se në kurrikulën e tyre trajnuese, për çdo vit planifikohen dhe realizohen trajnime nga fusha e të drejtave të njeriut.

Ndërsa, sa i përket pengesave apo mos implementim të këtyre neneve nga sistemi gjyqësor dhe ai prokurorial, nga Akademia kanë thënë se autoritet kompetentë për vlerësimin e kësaj problematike janë KGJK dhe KPK.

“Duke iu referuar vetëm vitit 2019 dhe deri më tani Akademia e Drejtësisë ka realizuar 10 aktivitete trajnuese në fushën e të drejtave të njeriut me theks të veçantë për Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Nga këto aktivitete trajnuese nga lista e gjyqësorit kanë përfituar gjithsejtë 108 gjyqtarë, 22 prokurorë dhe 16 pjesëtare nga stafi administrativ i gjykatave dhe prokurorive” – thuhet në përgjigjen që Akademia e Drejtësisë ka dhënë për IKD-në.

Përveç aktiviteteve trajnuese, sipas përgjigjes së Akademisë, e njëjta ka hartuar edhe një Doracak për të Drejtat e njeriut i cili i dedikohet gjyqtarëve dhe prokurorëve ku për secilin nen të Konventës janë të elaboruara nga dy-tre raste në funksion të zbatimit në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Hartimit të këtij Doracaku, sipas Akademisë, i kanë paraprirë tryezat me gjyqtarë dhe prokurorë të cilët kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në selektimin e temave duke parashtruar nevojat e tyre në çështjet më sfiduese si: çështjet e pronës, çështjet trashëgimore, çështjet e diskriminimit, kompensimi i kërkesave kur është kufizuar liria e shprehjes, kohëzgjatja e hetimeve, ushtrimi i fesë dhe shumë çështje tjera.

Njëjte sikurse gjetjet e IKD-së edhe Institucioni i Avokatit të Popullit, sipas një përgjigje me shkrim që ka dhënë për IKD, kanë theksuar se gjatë trajtimit të rasteve që i kanë pasur, kanë vërejtur në vazhdimësi se në vendimet e gjykatave, gjyqtarët në raste të pakta i referohen instrumenteve ndërkombëtare dhe praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në ato raste kur kjo ndodh, ato janë të përgjithësuara dhe jo konkrete në raport me rrethanat e rastit në praktikë.

Për më tepër, duke cituar gjetjet e IKD-së se aplikimi i neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës në aktgjykimet e gjykatave nuk i kalon 10%, nga IAP kanë theksuar se ky numër është edhe më i ulët se aq, pasi sipas tyre, vetëm përmendja e përgjithësuar apo citimi i neneve të Konventës dhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nuk nënkupton

implementim të neneve të sipër përmendura, por vendimet duhet të jenë përmbajtësish të bazuara, të arsyetuara dhe të përcaktojnë në mënyrë konkrete vlerësimet e GjEDNj dhe lidhshmërinë e rrethanave të rastit në praktikë, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GjEDNj.

Një nga pengesat kryesore në mos zbatimin e këtyre neneve nga gjykatat në Kosovë, sipas Avokatit të Popullit, është fakti se që nga momenti i hyrjes në fuqi të Kushtetutës e deri më sot, kurrikula e Fakultetit Juridik nuk i përgatit studentët e rinj lidhur me të drejtën precedentale të GjEDNj dhe zbatimin e saj, siç kërkohet me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në mënyrë që pastaj këto kuadrat ë jenë profesionalisht të përgatitura për zbatim të kësaj dispozite.

“Mos aplikimi i neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës shkel të drejtat kushtetuese të qytetarëve të Republikës së Kosovës, paraqet papërgjegjshmëri dhe mungesë të llogaridhënies karshi qytetarëve. Si shembull mund të përmendim faktin se për çfarëdo ankese lidhur me zvarritjen e procedurave gjyqësore, e cila ka ndikuar në shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm kohor, nuk ka ndonjë mjet efektiv juridik karshi këtyre ankesave që si rezultat do të mund ta kishin pasur ndonjë lehtësim në formë të parandalimit të shkeljes apo në formë kompensimit dhe për këtë arsye me qëllim të krijimit të një mekanizmi mbrojtës ligjor të të drejtave të qytetarëve në raport me gjyqësorin” – thuhet në përgjigjen e IAP për IKD.

Lidhur me këtë, nga Avokati i Popullit kanë thënë se i kanë rekomanduar Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë, ndërmarrjen e nismës legjislative për propozimin e ligjit për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, me të cilin do të përcaktoheshin mjetet efektive juridike për rastet që kanë të bëjnë me zvarritjen e procedurave gjyqësore, në pajtim me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut.

Tutje, nga Institucioni i Avokatit të Popullit kanë thënë se, sa i përket mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në lëmin e gjyqësorit ka mandat të kufizuar, të përcaktuar me Ligjin për Avokatin e Popullit, sipas të cilit Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor, duke mos ndërhyrë në raste dhe në procedura ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç çështjeve që kanë të bëjnë me pretendimet për administrimin e drejtësisë, përkatësisht me rastet e zvarritjeve të procedurave gjyqësore dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

“Avokati i Popullit qysh në vitin 2009 i ka rekomanduar Kuvendit të Republikës së Kosovës, dërgimin e një grupi ekspertësh në GjEDNj, për ekspertizë sa i përket zbatimit të nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Së fundmi Avokati i Popullit i ka rekomanduar Fakultetit Juridik, plotësimin e kurrikulës me një lëndë të re të rregullt e cila do informonte të gjithë studentët e rinj me të drejtën precedentale të GjEDNj dhe zbatimin e saj sipas nenit 53.” – thuhet tutje në përgjigjen e IAP.

Gjithashtu, me qëllim të lehtësimit të punës për të gjithë subjektet e së drejtës, gjyqtarët, prokurorët, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, si dhe të gjithë të interesuarit, nga Avokati i Popullit kanë thënë se kanë lansuar Platformën për të drejtat e njeriut, e cila ka për qëllim promovimin e zbatimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, siç garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, aktet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe me ligjet e zbatuara në Kosovë.

Në fund, në përgjigjen e IAP thuhet se në të gjitha raport me rekomandime për zvarritje procedurale, të cilat ia ka drejtuar gjyqësorit, ia ka rikujtuar dhe i është referuar në vazhdimësi të drejtave të qytetarëve të Republikës së Kosovës bazuar në nenin 22 dhe nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe ka konstatuar ne rastet konkrete se ka pasur shkelje të të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, brenda një afati të arsyeshëm kohor të përcaktuar dhe të mbrojtur me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), të drejtën për mjete efektive juridike të mbrojtura me nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 13 të KEDNJ dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore të drejtave të përcaktuara në nenin 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Për problematikën që trajton ky raport, IKD ka zhvilluar një intervistë edhe me profesorin universitar dhe ish-kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani.

Sipas Hasanit, zbatimin e neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës e kanë obligim jo vetëm gjyqësori, por të gjitha institucionet publike. Sipas tij, me rastin e interpretimit të marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare me qëllim të zbatimit të tyre të drejtpërdrejt, gjykatat dhe autoritetet tjera publike duhet së pari të konstatojnë nëse normat që përmbajnë këto aktet juridike nga neni 22 kanë natyrë të vetë ekzekutueshme dhe nëse ky nuk është rasti, atëherë gjykatat dhe organet tjera publike duhet të interpretojnë këto akte juridike vetëm në pajtim me norma vënien implementuese të tyre që mund të jetë një normë kushtetuese, ligj, akt nënligjor, akt administrativ dhe çdo akt tjetër i nxjerrë me qëllim të implementimit të akteve juridike nga neni 22 i Kushtetutës.

Siç thuhet në përgjigjen e prof.dr.Hasani, çdo interpretim i lirive dhe të drejtave të njeriut që përbejnë ato akte juridike që numërohen në nenin 22 të Kushtetutës duhet të jetë tërësisht në pajtim me jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut dhe kjo nënkupton që gjykatat e rregullta duhet të vejnë në jetë në mënyrë besnike standardet juridike dhe të tjera lidhura me liritë dhe të drejtat e njeriut pikërisht ashtu siç janë vënë nga Gjykata e Strasburgut dhe asnjëherë ndryshe.

Shkallën e ulët të aplikimit të neneve në fjalë nga ana e gjykatave, Hasani e sheh si shumë shqetësuese duke thënë se kjo gjendje ekziston që një kohë të gjatë dhe se nuk ka ndonjë vullnet për të përmirësuar diçka në këtë aspekt.

Pengesa kryesore sipas Hasanit në këtë aspekt, ka të bëjë me mungesën e trajnimit dhe ekspertizës së gjyqtarëve me jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut dhe në përgjithësi me teorinë dhe praktikën e lirive dhe të drejtave të njeriut.

“Këtë e them bazuar në përvojën time konkrete me trajnimet që kam pasur me gjyqtarët e gjykatave të Kosovës të të gjitha niveleve, ku kam vërejtur një mungesë të theksuar të ekspertizës së gjyqtarëve në sferën e lirive dhe të drejtave kushtetuese; ajo që vërehet te ta është një dogmatizëm dhe formalizëm i theksuar, i trashëguar nga gjeneratat e kaluara dhe nga edukimi klasik që e kanë marr në Fakultetin Juridik, ku aspektet kushtetuese, teorike dhe filozofike mbi liritë dhe të drejtat e garantuara me Kushtetutë nuk janë fare prezent.” – ka thënë Hasani në intervistën dhënë për IKD.

Pasojat që vijnë nga mos aplikimi i këtyre neneve, sipas Hasanit, do të jenë se, Kosova me këtë moszbatim dhe injorim të tërësishëm të detyrimeve kushtetuese do të ketë telashe të mëdha në rrugëtimin e saj për në Gjykatën e Strasburgut dhe për pasojë, kur të jetë anëtar i saj, do të paguajmë miliona euro për cenimet e të drejtave të njeriut në Kosovë, si pasojë e mos zbatimit të standardeve evropiane nga jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut.

Konstatimin e IKD-së se me mos aplikimin e këtyre neneve, gjykatat nuk po e zbatojnë Kushtetutën, Hasani e ka cilësuar si konstatim me vend, veçse ka shtuar se një gjetje e tillë duhet të shoqërohet me një siç ka thënë, recetë për terapinë e duhur për tejkallim të kësaj diagnoze të dhënë nga IKD.

Adresimin e kësaj çështje, Hasani e sheh përmes një programi gjithëpërfshirës bazuar në një metodologji eficient të hulumtimit të analizës ku do të adresoheshin të gjitha segmente e kësaj gjendje të rëndë sipas tij, të nivelit të ulët të implementimit të standardeve evropiane për liritë dhe të drejtat e njeriut.

“Ai program do të përfshinte, *inter alia*, këto komponentë: E para, konstatimi i gjendjes së personelit dhe nivelit të tij që sot popullon gjyqësorin e Kosovës; E dyta, konstatimi i gjendjes së financave (kostos financiare) për “in job training” të gjyqësorit të Kosovës (dhe segmenteve të tjera të sistemit të drejtësisë që janë në zinxhirë apo në rrethin e njëjtë me gjyqësorin, si psh. prokuroria, policia, por, mbi të gjitha, fakultete juridike); E treta, konstatimi i kohës (gjatësisë) së sanimit të gjendjes ekzistuese; E katërta, konstatimi i bazenit të kuadrit kompetent për të ekzekutuar programin që synon vënien në jetë të këtij detyrimi kushtetues nga neni 53 i Kushtetutës” – ka thënë Hasani.

Po ashtu, Hasani ka shtuar se ka vërejtur një të metë të madhe siç e ka quajtur ai, tek Gjykata Supreme. Sipas tij, ka vendime të kësaj gjykate që thirren në zbatimin e drejtpërdrejtë të vendimeve të Gjykatës së Strasburgut, në ndërkohë që bëhet fjalë për mosdije dhe zbatim tërësisht të gabuar të së drejtës materiale.

“Kështu, ta zëmë, ekziston rasti për zgjedhjet (por edhe disa rastet të tjera), ku Gjykata Supreme gjoja zbaton në mënyrë të drejtpërdrejte dispozitat e Protokollit të Parë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ai Protokoll përcakton detyrime për shtetet anëtare të Konventës, jo për gjykatat. Ato detyrime për shtete anëtare (ku hyn edhe Kosova sepse njëanshëm ka pranuar detyrimet nga Konventa), kanë të bëjnë me marrjen e masave legjislative, administrative dhe gjyqësore për të vënë në jetë detyrimet që kanë të bëjnë, në rastin konkret, me zgjedhjet e përgjithshme. Këto detyrime Kosova i ka kryer duke nxjerrë

ligjin përkatës për zgjedhjet, duke formuar organe administrative për të adresuar padrejtësisë gjatë zgjedhjeve dhe duke ia njohur gjyqësorit të drejtën e kontrollit të ligjshmërisë së veprimeve administrative gjatë zgjedhjeve. Këtë e ka bërë Kosova (dhe vendet tjera), për arsye se dispozitat e Konventës dhe protokolleve të saj përcaktojnë standarde (të cilat i ven në jetë Gjykata e Strasburgut), dhe në të shumtën e rasteve janë dispozita që nuk kanë karakter të vetëekzkeutueshëm”- thuhet në përgjigjen e Hasanit.

Kjo, sipas ish-kryetarit të Kushtetueses, do të thotë se vendet anëtarë duhet të nxjerrin ligje dhe të marrin masa të tjera për t’i garantuar standardet e vëna në Konventë dhe në protokollet e saj dhe kjo e bën të pakuptimtë, sipas tij, në tërësi citimin e drejtpërdrejtë në vendimet e Gjykatës Supreme të Protokollit të dytë të Konventës, duke thënë se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë bie ndesh me te dhe, për pasojë, nuk duhet të zbatohet nga kjo gjykatë.

Me këtë veprim, sipas Hasanit, Gjykata Supreme ka bërë kontrollin e kushtetutshmërisë së Ligjit për Zgjedhjet, gjë që nuk është punë dhe detyrim i saj kushtetues. Krejt çfarë ka mund dhe është dashur të bëj Gjykata Supreme, sipas Hasanit, është ta dërgoj rastin në Gjykatën Kushtetuese, përmes procedurës së kontrollit incidental nga neni 113.8 i Kushtetutës dhe jo vetëm të gjykoj çështje kushtetuese.

IX. Përfundime

- Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në Kushtetutën e Republikës së Kosovës paraqet një rregull specifik, i cili rregullim paraqet edhe një specifikë të rendit kushtetues kosovar. Në përkufizimin kushtetues të shtetit thuhet se “*Republika e Kosovës ushtron autoritetin e saj bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të vet dhe të gjithë individëve brenda kufijve të saj*”. Po ashtu, respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut përcaktohet edhe si vlerë e rendit Kushtetues të Republikës së Kosovës.
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka “betonizuar” vetën sa i përket të drejtave dhe lirive të njeriut, duke bërë që në këtë pjesë, të pamundësohet edhe amandamentimi kushtetues.
- Me qëllim të avancimit të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka konstitucionalizuar tetë (8) instrumente ndërkombëtare që garantojnë dhe promovojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.
- Obligueshmërinë e zbatimit dhe respektimit të këtyre instrumenteve ndërkombëtare Republika e Kosovës e ka përcaktuar me Kushtetutë, sipas të cilit akt, të njëjtave u ka dhënë zbatueshmëri të drejtpërdrejtë dhe prioritet në raport me të gjitha ligjet tjera.
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përcaktuar një pikë reference me rastin e interpretimit të të drejtave dhe lirive të njeriut. Thënë më ndryshe, përderisa të drejtat dhe liritë e njeriut janë garantuar si nga norma kushtetuese ashtu edhe nga instrumentet ndërkombëtare si në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

në po këtë kushtetutë është përcaktuar edhe mënyra se si këto të drejta duhet të interpretohen në praktikë.

- Me këtë rast, si pikë referencë sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës paraqitet jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
- GjEDNj në kuadër të fushëveprimtarisë së saj, me vendimet që ka nxjerrë, ka strukturuar përmbajtjen e të drejtave të përcaktuara me KEDNj, me ç’ rast për secilën të drejtë dhe liri të njeriut, ka përcaktuar përmbajtjen, shtrirjen, ka vendosur standarde etj. Në këtë mënyrë, në përputhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, secili institucion publik duhet që të zbatojë të drejtat e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë dhe instrumentet ndërkombëtare të përcaktuara me nenin 22 të Kushtetutës, derisa interpretimi i këtyre të drejtave duhet të bëhet sipas shtrirjes, përmbajtjes dhe standardeve të vendosura nga jurisprudenca e GjEDNj-së.
- Para së gjithash, aplikimi i këtyre dy neneve kushtetuese, ashtu si edhe të normave të tjera kushtetuese nga ana e institucioneve publike, në rastin konkret sistemit gjyqësor, paraqet obligueshmërinë më të lartë juridike në rendin juridik kosovar. Kjo pasi një obligim i tillë rrjedhë nga akti më i lartë juridik, Kushtetuta. Neni 16.1. i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se “*Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës...*”. Në anën tjetër, detyrueshmëria e sistemit gjyqësor për respektimin e Kushtetutës është detyrimi bazë i këtij sistemi. Neni 102.3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se “*Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit*”.
- Në këtë mënyrë, mos zbatimi i këtyre normave kushtetuese, në rastin konkret neneve 22.2 dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, paraqet mos aplikim të aktit më të lartë juridik nga pushteti më i thirrur për ta bërë këtë, ai gjyqësor.
- Sa i përket të drejtave dhe lirive të njeriut, norma kushtetuese e ka para harmonizuar praktikën gjyqësore, për arsye se ka referuar në një praktikë gjyqësore të konsoliduar dhe harmonizuar, atë të GjEDNj-së. Në këtë mënyrë, përkundër faktit se legjislacioni i Republikës së Kosovës është relativisht i harmonizuar me instrumentet e caktuara ndërkombëtare dhe veçanërisht me KEDNj-në, teksti i këtyre normave juridike është i më i përgjithshëm, dhe detajizimi është bërë nga ana e jurisprudencës së GjEDNj-së.
- Lidhur me aplikimin e neneve 22.2 dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me qëllim të krijimit të një pasqyrë të përgjithshme mbi zbatimin dhe mos zbatimin e këtyre dy neneve kushtetuese, IKD ka analizuar gjithsej 209 aktgjykime.
- Gjetjet e IKD-së për këtë pjesë janë se vetëm në raste përjashtuese, gjykatat i referohen KEDNj-së sipas nenit 22.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe vendimeve të GjEDNj-së. Përkatësisht, gjetjet e IKD-së për këtë pjesë dërgojnë në konkludimin se këto dy nene kushtetuese janë pothuajse të “vdekura” në praktikën e gjyqësorit të Republikës së Kosovës.
- Nga 209 aktgjykime, në vetëm 20 prej tyre është aplikuar KEDNj sipas nenit 22.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Shprehur në përqindje, neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës është aplikuar në vetëm 9.56% të rasteve, derisa nuk është aplikuar në 90.43% të rasteve të tjera.

- Ndërsa, nga 209 aktgjykime të analizuara, gjykatat e Republikës së Kosovës në vetëm 19 raste kanë aplikuar vendimet e GjEDNj-së. Kthyer në përqindje, këto vendime janë aplikuar në vetëm 9.09% të rasteve, derisa nuk janë aplikuar në 90.90% të rasteve.
- Në këtë drejtim, gjetjet e IKD-së dëshmojnë se sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës, 12 vjet hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, vazhdon të mos aplikojë dy (2) prej neneve kryesore kushtetuese që kanë të bëjnë me të drejtat dhe liritë e njeriut, të garantuara me aktin më të lartë juridik në Republikën e Kosovës.
- IKD vlerëson se një statistikë e tillë duhet të trajtohet seriozisht nga ana e sistemit gjyqësor, para së gjithash për faktin se thjesht mos aplikimi i këtyre dy neneve kushtetuese nga institucionet që janë pothuajse më të thirrurat për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e njeriut, paraqet mos respektim të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës duhet ta ketë parasysh rëndësinë që ky institucion ka në ndërtimin e një rendi juridik praktika e të cilit ndërtohet në respektimit e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe harmonizimin e rendit juridik kosovar me praktikën e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, e veçanërisht me KE-në.
- Sa i përket ngritjes së përqindjes së aplikimit të këtyre dy neneve kushtetuese nga ana e Gjykatave të Republikës së Kosovës, IKD konsideron se është e rëndësishme jetike që gjyqtarët të trajtohen në mënyrë meritore dhe profesionale për aplikimin e instrumenteve ndërkombëtare të përcaktuara në nenin 22 të Kushtetutës dhe vendimeve të GjEDNj-së sipas nenit 53 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, roli qëndron i takon Akademisë së Drejtësisë, derisa në këtë proces duhet të ketë rol pro aktiv edhe KGJK, në mënyrë që të ngritë zbatimin e këtyre dy (2) neneve në aktgjykimet e gjykatave të Republikës së Kosovës.
- Sa i përket aplikimit të këtyre dy (2) neneve kushtetuese sipas gjykatave, në aplikimin e KEDNj-së sipas nenit 22.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës prin Gjykata Supreme, derisa sa i përket aplikimit të vendimeve të GjEDNj-it sipas Gjykatave, në aplikimin e këtyre vendimeve sipas nenit 53 të Kushtetutës prin Gjykata Themelore në Prishtinë.
- Në aplikimin e nenit 22.2 dhe 53 të Kushtetutës sipas natyrës së rasteve, përkatësisht departamenteve të gjykatave, në të dy rastet prinë DÇA i GjTh në Prishtinë.
- Në aplikimin e jurisprudencës së GjEDNj-it sipas nenit 53 të Kushtetutës dhe instrumenteve ndërkombëtare të listuara në nenin 22 të Kushtetutës prin Gjykata Supreme, pasuar nga Gjykatat Themelore, derisa këto dy nene të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në asnjë rast nuk i ka zbatuar Gjykata e Apelit.
- IKD shpreh shqetësim për mos aplikimin e dy neneve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës nga ana e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës, nene këto kryesore në fushën e të drejtave dhe lirive kushtetuese të njeriut. Në këtë drejtim, përqindja e aplikimit të këtyre dy neneve kushtetuese nga Gjykata Supreme dhe Gjykatat Themelore paraqet vetëm përjashtim, dhe kjo përqindje në asnjë rrethanë nuk paraqet as për së afërmi shkallë optimale të zbatimit të nenit 22.2 dhe 53 të Kushtetutës së

Republikës së Kosovës. Për këtë arsye, angazhimi për të adresuar këtë dukuri në sistemin gjyqësor, duhet të fillojë pothuajse nga zero.

- Por, situata edhe më keq qëndron në Gjykatën e Apelit. Në asnjë prej rasteve të analizuara në këtë raport, IKD nuk ka gjetur aplikim KEDNj-së sipas nenit 22.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe as të ndonjë vendimi të GjEDNj-it sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Pra, këto dy nene kushtetuese janë nene inekzistente në punën e Gjykatës së Apelit. Me këtë rast, IKD e vlerëson si shqetësuese këtë mos zbatim të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në rastin konkret 22.2 të 53 të Kushtetutës, nga ana e Gjykatës së Apelit. Për më tepër, kjo Gjykatë, krahas Gjykatës Supreme, do të duhej të vendoste standarde për trajtimin e rasteve nën frymën dhe zbatimin e këtyre dy (2) neneve kushtetuese. Madje, e njëjta gjykatë do të mund edhe të ndryshonte apo të kthente në rivendosje rastet e gjykatave themelore, nëse të njëjtat bien në kundërshtim me KEDNJ sipas nenit 22.2 apo vendimet e GjEDNj-it sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

X. Rekomandime

1. Gjykatat e Republikës së Kosovës ta kenë parasysh rëndësinë e aplikimit të dispozitave kushtetuese dhe rolin që kanë këto institucione në fuqizimin e zbatimit të Kushtetutës në rendin juridik kosovar.
2. Gjyqtarët e gjykatave të Republikës së Kosovës ta qartësojnë pozitën KEDNj sipas nenit 22.2 të Kushtetutës dhe vendimeve të GjEDNj-it në rendin juridik kosovar.
3. Gjyqtarët të studiojnë dhe analizojnë vazhdimisht KEDNj-it.
4. Gjyqtarët të studiojnë dhe analizojnë vazhdimisht vendimet e GjEDNj-it.
5. Gjyqtarët të kenë parasysh benefitet që nxjerrin nga jurisprudenca e konsoliduar e GjEDNj-it.
6. Në punën e tyre, gjyqtarët të aplikojnë dispozitat e KEDNj-it sipas nenit 22.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe vendimet e GjEDNj-it.
7. KGJK të trajtojë me seriozitet mos aplikimin e këtyre dy neneve kushtetuese nga ana e gjykatave të Republikës së Kosovës.
8. Akademia e Drejtësisë të bëjë përpjekje maksimale për të trajnuar gjyqtarët në aplikimin e KEDNj-it sipas nenit 22.2 të Kushtetutës dhe vendimeve të GjEDNj-it sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
9. Të gjitha gjykatat dhe veçanërisht Gjykata e Apelit të respektojnë Kushtetutën, në rastin konkret nenet 22.2 dhe 53 të saj dhe të mos heshtin përballë këtyre dy (2) dispozitave kushtetuese, pasi kjo heshtje shndërron këto (2) nene kushtetuese në dispozita të “vdekura” në praktikë.
10. Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme të anulojnë/ndryshojnë vendimet në të cilat nuk janë respektuar dispozitat e KEDNj-it apo standardet e vendosura në jurisprudencën e GjEDNj-it.
11. Sistemi gjyqësor i Republikës së Kosovës ta ketë parasysh faktin se aplikimi i këtyre dy (2) neneve të Kushtetutës së Republikës së Kosovës paraqet para përgatitje të rendit juridik kosovar për anëtarësim në organizata ndërkombëtare dhe kjo rëndësi veçanërisht paraqitet në synimin e Republikës së Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës.

12. Edhe prokurorët dhe avokatët në shkresat e deponuara në gjykatë ti referohen edhe KEDNj-it dhe vendimeve të GjEDNj-it, në mënyrë që të njëjtit të kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së drejtësisë në Republikën e Kosovës.